

ÇFARË PËRFAQËSON? SELIA, KOMPETENCAT TOKËSORE DHE KONTAKTET

1 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ushtron veprimtarinë gjyqësore e administrative me seli në qytetin e Gjirokastrës dhe kompetencë tokësore në bashkitë Gjirokastër, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë dhe Dropull.

2 Gjykata e e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër fillon funksionimin më datë 01.05.2023.

3 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet ndërpret veprimtarinë më datë 30.04.2023.



Adresa e Gjykatës:

Lagjja “18 Shtatori”

Kontakte:

✉ rrethigjirokaster@gjykata.gov.al

☎ +355 8426 2550



GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR

CILAT JANË ORGANET E ADMINISTRIMIT
GJYQËSOR?

- **Këshilli i Gjykatës**
- **Kryetari/
Zëvendëskryetari**
- **Kancelari**

TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM **GJIROKASTËR**

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË TRANSFEROHEN NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR

Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe Përmet deri në datën 30.04.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë **nuk** i nënshtrohen rindarjes me short elektronik. Këto çështje vijojnë të shqyrtohen nga i njëjti trup gjykues.

ÇËSHTJET GJYQËSORE **NUK** RINDAHEN ME SHORT

Numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë është 7 gjyqtarë.

Strukturat e shërbimeve gjyqësore të përbëra nga Kryesekretari dhe Sekretarët Gjyqësorë mbështesin drejtpërdrejt veprimtarinë gjyqësore të gjykatës.

Strukturat e shërbimeve administrative të tilla si: buxheti dhe financa, teknologjia e informacionit, burimet njerëzore dhe protokoli/arkivi, etj., janë përgjegjëse për mirëfunksionimin e veprimtarive administrative të gjykatës.

Zyra e Shërbimeve Përmet ngrihet dhe funksionon pranë godinës së ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet e riorganizuar, për të ofruar shërbime administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.

KËRKESAT QË MUND TË PARAQITEN NËPËRMJET ZYRAVE TË SHËRBIMEVE NË RRETHE

- Kërkesa/Kërkesëpadi dhe akte të tjera procedurale/provuese në numër sa janë palët ndërgjygjëse;
- Kërkesat për plotësim, sqarim, interpretim vendimi dhe ndreqje gabimi;
- Kërkesë për kopje vendimi/akteve nga Zyra e Arkivës;
- Kërkesë për kopje të akteve për çështje gjyqësore në proces;
- Ankimet/kundërankimet;
- Kërkesë për vërtetim mbi çështjet e gjykuara apo në gjykim;
- Kërkesë për informacion mbi çështjet e regjistruar në gjykatë;
- Kërkesë për përshpejtim të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
- Kërkesat për depozitimin e të dhënave të kontaktit të palëve apo përfaqësuesve të tyre për çështjet gjyqësore në proces si dhe çdo të dhënë për ndryshimin e adresave të vendbanimit.

- Depozitim të aktit të përfaqësimit të çështjeve gjyqësore të regjistruara;
- Kërkesa për përjashtim të trupi gjykues në çështjet civile;
- Kërkesat për heqje dorë nga ankimi;
- Kërkesat për informacion të publikut dhe medias;
- Kërkesat për çështjet gjyqësore në proces.

Ku ndodhen zyrat e shërbimit:

Gjykatat e shkallëve të para të judiksionit të përgjithshëm do të kenë 9 (nëntë) zyra shërbimi. Ato do të jenë funksionale pranë godinave të ish-gjykatave të rretheve gjyqësore Krujë, Kurbin, Mat, Tropojë, Pukë, Kavajë, Lushnjë, Pogradec dhe Përmet.



ZYRAT E SHËRBIMIT

ÇFARË JANË ZYRAT E SHËRBIMIT?

CILAT JANË FUNKSIONET E ZYRAVE TË SHËRBIMIT NË PERIUDHËN KALIMTARE?



ÇFARË JANË ZYRAT E SHËRBIMIT?

Zyrat e Shërbimit janë struktura të cilat ngrihen dhe funksionojnë pranë godinave të ish-Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Krujë, Kurbin, Mat, Tropojë, Pukë, Kavajë, Lushnjë, Pogradec dhe Përmet me qëllim ofrimin e shërbimeve administrative që lidhen me protokollin dhe arkivin gjyqësor.

Zyrat e Shërbimit janë pjesë e Sektorit të Protokollit, Arkivës dhe të Koordinimit të Zyrave të Shërbimit, në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Kancelarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe funksionimin e zyrave të shërbimeve dhe sigurojnë koordinimin me shërbimet e tjera të gjykatës.

CILAT JANË FUNKSIONET E ZYRAVE TË SHËRBIMIT NË PERIUDHËN KALIMTARE?

Nëpunësit e Zyrave të Shërbimit, kryejnë të gjitha detyrat e sekretarit gjyqësor si dhe veprimet që lidhen me administrimin e dosjeve gjyqësore të çështjeve të përfunduara deri në datën 30 prill 2023, të tilla si:

- komunikimin e vendimeve gjyqësore palëve ndërgjyqëse;
- verifikojnë ekstremitetet e kërkesës apo kërkesëpadisë lidhur me palët, adresën, gjykatës së cilës i drejtohet, provat, kartën e identitetit, aktin e përfaqësimit (nëse ka), plotësimin e formularit mbi të dhënat e kontaktit duke i listuar ato tek padia;
- numërtojnë dhe konfirmojnë kundrejt nënshkrimit të palës, numrin e fletëve të dorëzuara origjinale ose të noterizuara;
- verifikojnë pagimin e taksës apo tarifave gjyqësore;
- përcjellin pa vonesë për trajtim në strukturën qendrore të shërbimeve gjyqësore ose administrative të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm të gjitha aktet e paraqitura;
- pranimin, regjistrimin e ankimeve civile, penale dhe të masave të sigurimit në regjistrin e ankimeve, në sistemin e menaxhimit të çështjeve, si dhe në indekset e ankimeve;
- komunikimin e ankimit, kundërankimit (nëse ka) dhe pas përfundimit të veprimeve bën përcjelljen e dosjeve civile, penale për në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- kontrollon kryerjen e rregullt ose jo të komunikimit të vendimeve dhe kalon dosjet për formë të prerë;
- bën pritjen e përdoruesve të gjykatës, lidhur me ankimet e çështjeve gjyqësore dhe informon lidhur me ecurinë e dosjes;
- pas përfundimit të afatit të ankimimit nëse nuk ka ankim, dorëzon dosjet pranë zyrës së arkivës së gjykatës;
- kryerjen e detyrave të tjera sipas nevojës dhe delegimit nga Kancelari i Gjykatës.